

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 448 Rep.  
Nr. 122 Kol.



Tiranë, më: 09 .07.2015

## PROKURË E PËRGJITHSHME

Sot, me datën 09 .07.2015 (pesëmbëdhjetë), para meje noteres BLERTA KAÇELI, në Tiranë me zyrë në rrugën Myslym Shyri, Nr. 82, u paraqit personalisht :

**Z. Miodrag JANKOVIC**, shtetas i Republikës së Serbisë, njohës i gjuhës angleze, i biri i Dragolub, i datëlindjes 05.12.1978, lindur në Sremska Mitrovica/Serbi dhe banues në Sremska Mitrovica/Serbi, mbajtës i pasaportës së Republikës së Serbisë Nr. 007619452, dt.10.07.2009 madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili në cilësinë e Administratorit dhe Përfaqësuesit Ligjor të Shoqërisë Tregtare "ALBAMETAL" SHPK, me Nr. NIPT-i L43402201R, me seli në adresën: Fshati Bradashesh, Komuna Bradashesh, ndërtesë 3-katëshe, Zona Kadastrale Nr.3965, Pasuria Nr. 952/3, Elbasan, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, i asistuar nga përkthyesi i gjuhës angleze, Z. Dardan MUSTAJ, më deklaroi sa më poshtë:

Ai, me vullnetin e tij të lirë dhe të pa vesuar më kërkoi redaktimin e kësaj prokure të posaçme me përmbajtjen e mëposhtme :

"Unë i nënshkruari Miodrag JANKOVIC, jam aktualisht administrator dhe përfaqësues ligjor i shoqërisë tregtare "ALBAMETAL" SHPK, me seli në adresën: Ndërtesë 3-katëshe, Zona Kadastrale Nr.3965, Pasuria Nr. 952/3, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, me Nr. NIPT-i L43402201R sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Me anën e kësaj prokure, në cilësinë e administratorit, **autorizoj Z. Altin HOXHA**, shtetas shqiptar, i biri i Nazif dhe Shadije, i datëlindjes 26.02.1978, lindur në Trebisht –Mucine Dibër dhe banues në adresën: Rr. Aleksandër Goga, Lgj. 15, Spitalë/Durrës, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar Nr. 030096979, dhe Nr. Personal H80226006P, i cili të përfaqësojë shoqërinë tregtare "ALBAMETAL" SHPK, në shitjen dhe blerjen e automjeteve dhe makinerive të ndryshme, të përfaqësojë shoqërinë në kryerjen e veprimeve pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, të marrë pjesë në ankande e prokurime publike sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Për kryerjen e detyrave të mësipërme përfaqësuesi ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet që i konsideron të nevojshme, duke përgatitur përmbajtjen që dëshiron dhe nënshkruar në emër të shoqërisë, çdo dokument, procesverbal, marrëveshje, kontrata të ndryshme për realizimin e qëllimit për të cilin i jepet kjo prokurë.

Përfaqësuesi ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve gjyqësore si dhe pranë organeve të tjera administrative shtetërore apo pranë institucioneve publike apo private në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu përfaqësuesi, ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë pranë çdo institucioni doganor, si dhe të kryejë veprimet përkatëse, apo të nënshkruajë aktet përkatëse pranë tyre.



Përfaqësuesi ka të drejtë të lidhë kontrata pune, kolektive ose individuale, t'i nënshkruajë ato, të zgjidhë marrëdhëniet e punës me të punësuarit, të lidhë çdo lloj kontrate, në veçanti kontrata qiraje, shitblerjeje, sipërmarrjeje, shërbimesh. Ndër të tjera përfaqësuesi ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe para organeve gjyqësore e administrative, të nënshkruajë aktet përkatëse, në Republikën e Shqipërisë, për llogari të "Albamental" SHPK.

Përfaqësuesi ka të drejtë të lidhë kontrata të ndryshme, në emër të shoqërisë, të hyjë në marrëdhënie me të tretët, si dhe të bëjë çdo lloj veprimi të nevojshëm.

Përfaqësuesi, ka të drejtë të aplikojë për marrje leje, autorizime, licenca të ndryshme në emër të shoqërisë, pranë institucioneve të ndryshme në Republikën e Shqipërisë, të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm teknik apo ligjor etj, deri në marrjen e tyre sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Nëse është e nevojshme apo kur dhe ai vetë e sheh të nevojshme, përfaqësuesi ka të drejtë të delegoje një pjese apo te gjitha tagrat e dhëna sipas kësaj prokure personave te trete. Për këtë qëllim ai ka të drejtë që nëpërmjet një autorizimi të shkruar të autorizojë në emër të shoqërisë persona të tjerë për kryerjen e veprimeve specifike.

Kjo prokurë lëshohet pa afat dhe është e vlefshme deri në shfuqizimin e saj nga ana ime apo kur vetë përfaqësuesi heq dorë prej saj.

Me kete Prokurë shfuqizoj në gjithë tërësinë e saj Prokuren Nr. 165 REP dhe Nr. 30 KOL datë 15.12.2014 (notere Blerta Kaçeli) dhe z. Artan PJETËRNIKAJ nuk është më përfaqësuesi i shoqërisë tregtare "ALBAMETAL" SHPK.

Çdo veprim juridik te kryer prej tij pas kësaj Prokure, unë e konsideroj absolutisht të pavlefshëm dhe pa asnjë pasojë juridike.

Ky akt pasi u redaktua në 5 (pesë) kopje prej meje noteres, ju përkthye në gjuhën angleze të interesuarit, zotrues i kësaj gjuhe, i cili e dëgjoi e miratoi dhe nënshkroi atë në prezencën time. Ky akt u përkthye prej përkthyesit Z. Dardan Mustafaj, i biri i Besnik, lindur më dt. 26.07.1984, në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rr. Ded Gjo Luli, P5, shk 3/36 Tirane, i njohur prej meje noteres prej letërnjoftimit Nr.024474721, dt.03.03.2009, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili zotron gjuhën angleze dhe nënshkroi në prezencën time.

Akti nënshkruhet dhe prej meje noteres.

## I PËRFAQËSUARI

Administrator i Shoqërisë  
"ALBAMETAL" SHPK

Z. Miodras Jankovic

*Miodras Jankovic*

Përkthyesi: Z. Dardan Mustafaj

*Dardan Mustafaj*

## NOTERI

BLERTA KAÇELI

*Blerta Kaçeli*

*Blerta Kaçeli*